

# Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qëndrore - Protokoli 6 Shtesë



## Palët e CEFTA-s:

- Shqipëria
- Bosnjë dhe Hercegovina
- Maqedonia e Veriut
- Moldavia
- Mali i Zi
- Serbia
- Kosova\*

## Çfarë është CEFTA?

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qëndrore ('CEFTA') është një marrëveshje tregtare e cila synon:

- Të harmonizojë kuadrin rregullator të Palëve të saj me ato të Bashkimit Europian (BE) dhe standartet ndërkombëtare.
- Të rrisë tregtinë në mallra dhe shërbime duke eliminuar barrierat tregtare midis Palëve dhe duke tërhequr investime në rajon përmes rregullave tregtare të drejta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Protokoli AP6 është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2020 me Ligjin 46/2020

Kosova, edhe pse nuk e ka ratifikuar akoma AP6, ka praktikuar disa aktivitete që rrjedhin nga AP6

\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244 dhe Opininion e GjKND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## CEFTA Protokoli 6 Shtesë ('AP6')

AP6 vendos një kornizë për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve midis Palëve të CEFTA-s. Protokoli parashikon heqjen e kufizimeve në tregtinë e shërbimeve, lehtësimin e aksesit në treg dhe eliminimin e diskriminimit ndaj shoqerive të huaja nga Palë të tjera të CEFTA-s nga ato vendase.



## Por, pse shërbime?

- Tregtia e shërbimeve është rritur më shpejt se e mallrave.
- Edhe pse shërbimet drejtpërdrejtë përbëjnë vetëm rreth 1/4 të tregtisë globale, ato kontribuojnë në 45% të tregtisë globale në terma të vlerës së shtuar. Kjo për shkak se zinxhirët e vlerës globale janë gjithnjë e më intensive për shërbime.

Të gjitha bizneset mund të përfitojnë nga AP6 (edhe në bujqësi dhe industri) pasi do të kenë akses në shërbime ndërmjetësuese dhe efikase.

Angazhimet e AP6 liberalizojnë sektorët e shërbimeve profesionale si (auditimi, arkitektura, inxhinieria, konsulenca ligjore, etj.), informatika dhe shërbimet e lidhura me të, telekomunikacioni, ndërtimi, shpërndarja, shërbimet financiare, shëndetësia, arsimiti, turizmi dhe shërbimet e lidhura me udhëtimin, dhe transportin.



# PËRMIRËSIMI I EKSPERIENCAVE TË BIZNESIT

## NË SHËRBIMET E TREGTISË NDËRKUFITARE ME AP6 TË CEFTA-S

**S**ipas AP6, bizneset do të përfitojnë nga qasja e garantuar në treg dhe trajtimi kombëtar në Palët e tjera të CEFTA-s, që përfaqëson një hap thelbësor drejt bashkëpunimit rajonal. AP6 është i rëndësishëm si për qeveritë ashtu edhe për bizneset pasi synon të rrisë efikasitetin e burimeve, të promovojë inovacionin dhe transferimin e teknologjisë, të sigurojë akses në shërbime ndërmjetësuese më efikase, të ulë çmimet, të zgjerojë opsionet e konsumatorëve dhe, në përgjithësi, të lehtësojë investimet dhe hyrjen në tregjet e reja.

Falë AP6 të CEFTA-s, bizneset në rajon mund:

- Të kenë akses të shtuar në tregjet e reja, të zgjerojnë fushat e tyre të veprimit dhe të përfitojnë nga fuqia e tyre konkurruese.
- Të eksplorojnë sinergjitë dhe partneritetet e mundshme me shoqëri dhe furnizues të tjerë nga Palët e CEFTA-s.
- Të njihen me nivelet Europiane të tregtisë në liberalizimin e shërbimeve dhe lëvizjen e punëtorëve.

## AP6

hedh bazat për:

- Lejimin e personave fizikë për të ofruar shërbime në territorin e Palëve.
- Heqjen e barrierave në tregti, të tilla si kërkesat për liçencim ose kualifikimet profesionale.
- Zhvillimin e programeve të njohjes reciproke të dokumenteve dhe procedurave ndërmjet Palëve.
- Eliminimin e praktikave të biznesit të furnizuesve të shërbimeve që mund të frenojnë konkurrencën dhe të kufizojnë tregtinë e shërbimeve.
- Zhvillimin e tregtisë elektronike rajonale.
- Thelimin e mëtejshëm të integritimit ekonomik rajonal dhe përafrimin me kuadrin rregullator të BE-së.

Për të mesuar më shumë rreth projektit të AP6 të CEFTA-s – Mbështetje për Integrimin Rajonal, ju lutem vizitoni:

[Support to regional economic integration | CEFTA](#)

[CEFTA - Support to regional integration | ITC \(intracen.org\)](#)

*This publication is supported by the Open Regional Fund for South East Europe – Foreign Trade, commissioned by the European Commission and the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). The content of this publication represents the opinion of the author(s) and are not necessarily representative of the position of the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.*